




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 5453/ prot.
117

Tiranë, më 18.12.2023

Lënda: Dërgohet për shpallje publike



BASHKISË MALIQ

Në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Pjesa e VII, Neni 162, në mbështetje të Ligjit 64/2012 "Për peshkimin", Urdhrit nr.149, datë 31.03.2022, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 "Për Peshkimin", bashkëlidhur gjeni për shpallje publike në këndin e njoftimit në ambjentet e Bashkisë Maliq, njoftimin për anulimin e lejës së peshkimit Nr. LC-6922-06-2021, datë 14.6.2021 në përdorim të z. Gerald Vilas për subjektin:

1. Gerald Vilas

Lutemi, marrjen e masave për publikimin e njoftimit, sipas afateve të përcaktuara në shkresën bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

LAVDRIM SAHITAJ



STAMP
dt 20.12.2023

Mr. 188 Post
dt 21.12.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 5453/116 prot.

Tiranë, më 18.12.2023

Lënda: Njoftim për anulimin e lejës së peshkimit Nr. LC-6922-06-2021, datë 14.6.2021, në përdorim të z. Gerald Vilas.

z. Gerald Vilas

Adresa Nr.1: Durrës, Autoriteti Portual, Kalata e peshkimit

Adresa Nr.2: Rruga "Rinia", Ndërtesa 23, Hyrje 6, Ap.1, Maliq

Me Vendimin Nr. 191 prot., datë 15.12.2023 "Mbi shqyrtimin e propozimit për heqjen e lejës së peshkimit", mbi Lejen e peshkimi me Nr. LC-6922-06-2021, datë 14.6.2021, në përdorim të z. Gerald Vilas, në bazë të Ligjit 64/2012 "Për peshkimin, i ndryshuar si dhe nenit 32 të Urdhrit nr.149, datë 31.03.2022, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 "Për Peshkimin", si dhe pasi ezauroi të gjitha rrugët e njoftimit duke e njoftuar subjektin mbi afatin 10 ditor për kryerjen e pagesës, pas mospagesë së taksës nga ana e subjektit është vendosur:

- 1. Anullimi i lejës së peshkimit Nr. LC-6922-06-2021, datë 14.6.2021, në përdorim të z. Gerald Vilas, e cila humbet vlefshmërinë në mënyrë të përhershme.*
- 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.*

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Pjesa e VII, Neni 162 pika 3, bëjmë me dije se ky njoftim përveç se në këndin e njoftimit në ambientet e Njesisë Administrative Nr. 1, Durrës ku z. Vilas ka deklaruar aktivitetin e peshkimit, si dhe në adresën e vendbanimit Bashkia Maliq, gjendet edhe në këndin e njoftimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në faqen zyrtare "bujqësia.gov.al".

Subjekti z. Gerald Vilas mund të tërheqë kopjen e plotë të Vendimit Nr. 191 prot., datë 15.12.2023 duke paraqitur kërkesë në Protokollin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Njoftimi shpallet në datën 21.12.2023 dhe hiqet më datë 3.1.2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

LAVDRIM SAHITAJ

